



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.114 dt.28.09.2001

**MBI**

**NJE NDRYSHIM NE EMERTIMIN DHE STRUKTUREN ORGANIZATIVE TE  
NDERMARRJES SE TREGJEVE DHE TAKSAVE**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në vijim të Vendimit Bashkiak Nr.7 dt.05.02.1999 “Për organizimin dhe miratimin e strukturës organizative të ndërmarrjes së Tregjeve dhe Taksave”, ndryshuar me vendimin Nr.182 dt.19.11.1999, Vendimin Nr.82 dt.26.05.2000, bazuar në relacionin e paraqitur me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratohet ndryshimi i emërimit nga Ndërmarrja e Tregjeve dhe Taksave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tregjeve dhe Taksave
2. Të miratohet struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Tregjeve dhe Taksave prej 150 personash sipas materialit bashkëngjitur
3. Efektet financiare prej 993.000 lekësh/muaj (750.000 lekë art.600, 243.000 lekë art.601) të kalojnë në favor të Drejtorisë së Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tregjeve dhe Taksave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**



